Malaria- situata epidemiologjike në Kosovë nën kontrollë

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike gjatë mbikëqyrjes permanente të sëmundjeve ngjitëse në Kosovë, përmes sistemit të mbikëqyrjes të situatës epidemiologjike dhe grumbullimit të rasteve për periudhën e pasluftës në Kosovë (1999-2018) ka raportuar gjithsej 7 raste me Malarie, prej të cilave 2 rasteve të reja të sëmundjes së malaries në vitin 2018. Të dyja rastet janë të importuara nga nga shtetasit tanë të cilët në shtetet e Afrikës qëndrojnë për kohë të caktuar (Kongo dhe Nigeria).

Situata epidemiologjike me malaria në Kosovën e pasluftës karakterizohet me paraqitje të herë pas hershme të rasteve sporadike.

Malaria është sëmundje ngjitës, obligative transmisive, që përnga dekursi klinik mund të jetë akute apo kronike. Malaria ka shtrirje të gjerë gjeografike me koncentrim në zonat tropikale, subtropikale dhe ato me klimë të butë (kontinenti i Afrikës dhe Amerikës latine). Më shumë se një miliardë njerëz jetojnë në regjionet malarike, miliona prej tyre janë të infektuar dhe një numër i konsiderueshëm vdes nga sëmundja.

Malaria shkaktohet nga protozoa e gjakut e gjinisë Plazmodium. Njihen rreth 50 lloje të plazmodiumeve ku 4 prej tyre janë patogjene për njeriun;

a. Plazmodium malarie

b. Plazmodium vivax

c. Plazmodium falciparum

d. Plazmodium ovale

Sëmundja e malarjes është e përhapur në zonat tropikale, subtropikale dhe ato me klimë të butë. Më shumë se një miliardë njerëz jetojnë në regjionet malarike, miliona prej tyre janë të infektuar dhe një numër i madh vdes nga sëmundja.

Pas pickimit të mushkonjës duhet të kalojë 7 deri 14 ditë për tu shfaqur shenjat e sëmundjes te njeriu. Sëmundja shfaqet me ethe të forta e me të dridhura, të cilat e zënë njeriun herë pas here zakonisht në mbrëmje. Pastaj shfaqet temperaturë e lartë 39-40ºC, djersitje, fytyrë të skuqur, mundim, vjellje, kokëdhembje dhe shpejtim të pulsit. Te fëmijët sëmundja mund të shoqërohet me konvulzione për shkak të temperaturave të larta. I sëmuri i cili nuk mjekohet me kohë mund të bartë sëmundjen me gjakun e tij deri në tri vjet. Sëmundja bartet përmes gjakut të infektuar me transfuzion.

Sëmundja mjekohet me barna kundër malarjes të cilët shkatrrojnë parazitët e malarjes në gjakun e njeriut të sëmurë.

Nga malaria mund të sëmuren të gjithë pa dallim gjinie, moshe, race, profesioni apo përkatësie kombëtare poqese pickohen nga mushkonja që bartë me vete parazitin e malarjes.

Malaria më së shpeshti shfaqet në pranverën e vonshme, verë dhe vjeshtë.

Për tu mbrojtur nga malaria duhet luftuar mushkonjat të cilat bartin sëmundjen,

Të gjithë personat që jetojnë në vendet ku ka mushkonja apo udhtojnë në vendet tropikale duhet të përdorin repelent) për të parandaluar pickimin nga mushkonjat. Duhet gjithashtu të aplikohen rrjetat rreth shtratit të gjumit në vendet ku ka mushkonja dhe nuk mund të mbrohemi ndryshe.

Mjekimi me antimalarik duhet të filloj posa të diagnostikohet sëmundja.

Deri sot akoma nuk është zbuluar vaksinë efikase kundër malaries.

Rastet e malaries pritet të kemi edhe në të ardhmen duke pasur parasysh se situata epidemiologjike me malaria në vendet endemike është e pasigurt. Në vitin 2016 në botë nga kjo sëmundje janë prekur 216 milion raste në 91 shtete me 445.000 raste fatale.

Problemi qëndron se pacientët në fjalë edhepse mjekohen dhe konsiderohen të shëruar janë potencialisht burim i infeksionit (bartës të shkaktarit të sëmundjes deri në 3 vjet).

Pasi janë bartës të infeksionit për 3 vjetët e ardhshëm, mundësia e paraqitjes së rasteve autoktone ekziston për shkak të presencës së mushkonjave Anopheles.

- Të gjithë qytetarët tanë të cilët udhëtojnë në zonat endemike duhet t'i përmbahen rekomandimeve ndërkombëtare për marrje të masave parandaluese me marrjen e anti-malarikëve dhe gjithsesi para udhtimit të konsultohen me epidemiologët e Institutit Kombëtar.
- Shtetasit e huaj me origjinë nga zonat endemike me malaria të cilët vijnë në Kosovë duhet të dëshmojnë se nuk janë të infektuar me sëmundjen e malaries dhe për çdo shenjë klinike të paraqiten në Institutin Kombëtar për diagnostikim dhe te infektologu për trajtim.

Laboratoret e Institutit Kombëtar janë të përgaditura dhe të gatshme për diagnostikimin e të gjitha rasteve të dyshimta në Malarie.

Situata epidemiologjike me Malarie është në kontrollë të plotë dhe në mbikëqyrje permanente nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike.

Informatë për ecurinë e EHKK

Prishtinë, 6 Qershor 2018

Informatë për Media

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike gjatë mbikëqyrjes permanente të sëmundjeve ngjitëse në Kosovë, përmes sistemit të mbikëqyrjes të situatës epidemiologjike dhe grumbullimit të rasteve për periudhën **01 shkurt 2018-31 Maj 2018**, ka raportuar gjithsej **2201** raste të pickimeve nga rriqërat në Kosovë. Numri më i madh i pickimeve është nga komuna e **Malishevës 538 raste, Suhareka 446 raste, Klina 249 raste, Rahoveci 123 raste dhe komunat e tjera me numër më të vogël të rasteve.**

Krahasuar me periudhën e njejtë të viteve paraprake të kaluar është raportuat numër lehtë i rritur i rasteve të pickuara.

Rasti i parë pozitiv në Ethe Hemorragjike Krime Kongo në fshatin Bresalc, komuna e Gjilanit, i hospitalizuar ne Klinikën infektive të SHSKUK është trajtuar me sukses dhe është lëshuar në shtëpi.

Në Departamenti i Mikrobiologjisë janë testuar gjithsej 22 mostra (nga personat e dyshimtë në Ethe Hemorragjike Krime Kongo) të cilat kanë rezultuar negative.

Situata epidemiologjike me EHKK është në kontrollë të plotë dhe në mbikëqyrje permanente nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i cili zbaton strategjinë për parandalimin dhe luftimin e EHKK të Këshillit Ndërministror për luftimin e EHKK.

Epidemiologët e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë së Kosovës vazhdojnë të përcjellin me vëmendje ecurinë epidemiologjike në Kosovë.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës po përcjell në mënyrë permanente situatën epidemiologjike me Ethet Hemorragjike Krime-Kongo në të gjitha vatrat e infeksionit dhe bashkë me mjekët dhe punëtorët shëndetësor të Qendrave Kryesore të Mjekësisë Familjare në Malishevë, Rahovec, Klinë, Suharekë, Gjakovë po mbikëqyrin dhe hulumtojnë të gjitha vatrat, përfshirë këtu edhe vatrat endemike të komunave fqinje: Lipjan, Drenas, Skenderaj, Prizren, Dragash. Pas paraqitjes së rastit të parë në fshatin Bresalc të Gjilanit, ekipet e Institutit Rajonal në Gjilan tashmë kanë vizituar familjen e të sëmurit dhe po vëzhgojnë me përkushtim terrenin dhe situatën epidemiologjike.

Duke pasur parasysh se që nga viti 2013 nuk është shënuar asnjë rast fatal me EHKK pasi që kemi realizuar me sukses masat profilaktike dhe kundërepidemike, ne duhet të vazhdojmë realizimin e aktiviteteve në terren sepse kemi të bëjmë me një sëmundje endemike, vdekjeprurëse dhe praninë e rriqrave në vatrat endemike të cilat bartin virusin e EHKK.

Edhe pse rreziku nga ethet hemorragjike është më i vogël se vitet e kaluara, qytetarëve u bëhet apel që edhe më tutje të vazhdojnë të kenë kujdes nga pickimet e rriqrave, sidomos në zonat endemike pasiqë tashmë temperaturat kanë filluar të ngriten dhe rriqrat kanë filluar të dalin në sipërfaqe të tokës.

Laboratoret e Institutit Kombëtar janë të përgaditura dhe të gatshme për diagnostikimin e të gjitha rasteve të dyshimta në EHKK.

Instituti Kombëtar rekomandon qytetarët për sivjet:

1. **Mos qëndroni gjatë dhe pa nevojë në livadhe dhe vende me shkurre,**
2. **Nëse patjetër duhet të jeni të pranishëm në këto vende vesh rroba të gjata dhe pantallonat futni në çorapë,**
3. **Duhet të përdorni preparate me të cila lyejmë pjesët e trupit të cilat i dëbojnë insektet nga trupi i njeriut e sidomos në pjesët e zbuluara të trupit, (shuplakat, qafën),**
4. **Kontrolloni trupin mos keni ndonjë rriqër gjatë qëndrimit në vatër,**
5. **Kontrolloni përsëri trupin pas largimit nga livadhi apo vendet me shkurre,**
6. **Nëse keni rriqër në trup ofrohuni në qendrën më të afërt mjekësore sa më shpejt dhe mos i shtypni me dorë!**
7. **Kositja e barit të bëhet në vazhdimësi (oborr dhe livadhe),**
8. **Pastrimi dhe dezinfektimi i stallave të bëhet në vazhdimësi,**
9. **Mbajtja e higjienës personale në nivelin më të lartë,**

Instituti Kombëtar bënë thirje te qytetarët se duhet të punojnë në faktorët e përmirësimit të ekosistemit që nënkupton:

1. **Të punohen të gjitha tokat e punueshme,**
2. **Të kositen të gjitha livadhet me kohë dhe nga disa herë,**
3. **Të pastrohen kopshtet dhe pronat për rreth shtëpive,**
4. **Të pastrohen fermat ku mbahen bagëtitë dhe të largohen rriqrat nga trupi i kafshëve,**
5. **Të kihet kujdes në veshmbathje për të gjithë fermerët dhe anëtarët e tyre të familjeve që punojnë në fushë ku**

kurrsesi nuk guxohet të lihen këmbët e zbathura

6. **Fëmijët mos të lejohen të luajnë në livadhe e kopshte të pakositura dhe në mbrëmje të kontrollohet prania e rriqrave në tërë trupin.**